

Mundësi të tjera informimi

Këshillim individual

Për çdo pyetje tjetër mbi programin mbështetës CHANCE KSR mund të na kontaktoni përmes telefonit ose mund të takoni personalisht drejtorin e shkollës apo drejtorin e projektit. Ju lutem takimet i lini përmes e-mailit ose me telefon përmes sekretarisë.

Ne mirëpresim grupe të motivuara dhe pjesëmarrësve ju urojmë që tani një fillim të mirë në programin mbështetës CHANCE KSR!

Drejtoria e shkollës dhe skuadra e projektit


Informacioni shtesë mbi programin mbështetës CHANCE KSR të shkollës së kantonit Rojsbyhl Lucernë:

■ te faqja e internetit

www.ksreussbuehl.lu.ch/ausbildung/chancengerechtigkeit

■ te drejtori i projektit

- Kathrin Di Berardino, Email: kathrin.diberardino@edulu.ch
- Christian Fallegger, Email: christian.fallegger@edulu.ch
- Jörg Rentsch, Email: joerg.rentsch@edulu.ch



Bildungs- und Kulturdepartement
Kantonsschule Reussbühl Luzern
Ruopigenstrasse 40
6015 Luzern

Telefon 041 349 72 00
www.ksreussbuehl.lu.ch

LUZERN



CHANCE KSR

Program mbështetës për të rinj të motivuar me (ose pa)
prejardhje migracioni

Programi mbështetës CHANCE KSR

Fatkeqësisht, pabarazitë në sistemin arsimor zviceran janë akoma një fakt: Shumë të rinj të talentuar, por të pa favorizuar nga shoqëria me (ose pa) prejardhje nga migracioni përfundojnë shkollimin e tyre pas shkollës nëntëvjeçare ose më vonë dështojnë në gjimnaz.

Me programin tonë mbështetës CHANCE KSR ne ndihmojmë pjesëmarrësit që të përfundojnë me sukses kalimin në shkollën e kantonit, të përballojnë në planin afatgjatë kërkesat e mësimave në gjimnaz dhe të mund të përfundojnë maturën.

■ Kush përfshihet në programin mbështetës?

Programi mbështetës synon nxënësit me (ose pa) një prejardhje migracioni që kanë potencial dhe motivim të mjaftueshëm për gjimnazin, por që nuk kanë mbështetjen e duhur nga prindërit e tyre (financiarisht).

■ Si funksionon procesi i regjistrimit?

Mësuesit e klasave të shkollës fillore, shkollës nëntëvjeçare dhe mësuesit e shkollës së kantonit mund të lëshojnë letra rekomandimi për nxënësit/et e klasës së gjashtë fillore, e klasës 2/3. të shkollës nëntëvjeçare (A & B) dhe e nivelit të 2-të dhe të 4-të të shkollave të kantonit. Kjo letër rekomandimi dorëzohet bashkë me formularin e regjistrimit, certifikatën e fundit dhe kartën aktuale të taksave të prindërve. (Afati i regjistrimit 1 mars)

Teste të ndryshme (potenciali, motivimi), një letër motivimi nga nxënësit e interesuar dhe një intervistë pranimit formojnë bazën për pranimin përfundimtar në programin tonë të mbështetjes. Kjo fillon pas pushimeve të verës.

■ Cilat janë elementët e programit mbështetës?

- Elementi bërthamë i programit mbështetës është një trajnim individual që ofrohet për çdo pjesëmarrës.
- Si në gjimnazin e ulët ashtu edhe në atë të lartë ju ofrohet të paktën një herë "Këndvështrime kulturore".

a) Gjimnazi i ulët: (klasa e parë dhe e dytë LZG):

- Pjesëmarrësit ndjekin "Mësimin e mbikëqyrur" dy herë në javë.
- Ju përfundoni kurset mbështetëse 1 & 2 në gjermanisht dhe në rast nevojë merrni mësim DAZ (Gjermanishtja si gjuhë e dytë).

b) Gjimnazi i lartë (Klasa 3 dhe 6 LZG dhe KZG):

- Pjesëmarrësit ndjekin kursin e të shkruarit në gjermanisht në klasën e 4-t dhe të 5-të dhe në rast nevojë marrin mësim DAZ.
- Në rast nevojë në klasën e 3-të dhe të 4-të ata mund të bëjnë kurse matematike.
- Në klasën e 5-të dhe të 6 atyre ju ofrohet mbështetje për punimin e diplomës dhe zgjedhjen e studimeve.

■ Si funksionon trajnimi individual?

- Trajnimet bëhen nga mësues me përvojë, të trajnuar posaçërisht sipas Modelit të Burimeve në Zyrin (ZRM).
- Modeli i Burimeve në Zyrin është një trajnim i testuar mbi vetë-menaxhimin.
- Studentët përfitojnë strategji efektive për teknikën e të punuarit dhe organizimin, nxitjen e motivimit dhe këmbënguljen si dhe menaxhimin e stresit.
- Stërvitja fillon me një punë të përbashkët në grupin mbështetës. Kjo pasohet nga diskutime të rregullta me trajnerin personal.



Përshtypjet e një nxënësi në klasën e 4-t:

Trajnimi më ka ndihmuar shumë edhe në planin afatgjatë. Unë edhe tani përfitoj shumë nga këshillat dhe lojërat tuaja. Këto këshilla më kanë ndihmuar shumë për shembull për të vazhduar praktikën me gjuhën e huaj, por edhe për të arritur qëllimet që i kisha vënë vetes. Unë e di që pa trajnimin nuk do të mund ta përfundoja vitin shkollor dhe kurrë nuk do isha ndërë kaq mirë.

■ Kush qëndron pas programit mbështetës?

- Programi mbështetës CHANCE KSR është një projekt pilot 4 vjeçar i lançuar në verën e vitit 2019 nga drejtoria dhe mësues të përkushtuar të shkollës në kantonin Rojshbyhl.
- Përsa i përket përmbajtjes dhe anës konceptuale ai bazohet te projekti ChagALL, i cili aplikohet që prej 2008 në gjimnazet Unterstrass në Zyrin. Personat përgjegjës për ChagALL na këshillojnë në zbatim.
- Ne punojmë me shkollat fillore dhe nëntëvjeçare të zonës sonë.
- Projekti monitorohet dhe vlerësohet shkencërisht nga ekspertë të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Zyrin (ZHAW).

Përshtypjet e një nxënësi në klasën e 4-rt:

Me anë të trajnimit unë arrita ti vë vetes qëllime që mund ti arrija. Përmes bisedave me gjimnazistë të tjerë mësova që unë nuk isha i vetmi që ndonjëherë ndihesha i mbingarkuar me mësimet e shkollës. Për më tepër unë përfitova nga takimet e rregullta që të mbaja në vëmendje qëllimet që i kisha vënë vetes. Tani unë e di që provimi i maturës është i arritshëm, nëse unë do t'ia vë vetes një qëllim të tillë.

■ Kush janë trajnerët tanë?

- Drejtoria: Kathrin Di Bernardino (Mësuese biologjie)
- Martina Blättler (Mësuese historie dhe gjeografie), Edith Bollhalder (Mësuese gjeografie), Christian Fallegger (Mësues historie), Matteo Tardo (Mësues i gjuhës franceze dhe italiane) dhe Marc von Wartburg (Mësues fiskulture). Të gjithë trajnerët janë mësues me përvojë.



■ Kush e financon programin mbështetës?

- Programi mbështetës CHANGE KRS mbështetet nga fondacioni UBS Optimus.
- Kantonu Lucernë financon kurset mbështetëse dhe përmirësuese të gjuhës gjermane dhe matematikës, të shkruarit, gjermanishtja si gjuhë e dytë dhe mësimi i mbikëqyrur, i cili është i hapur për të gjithë nxënësit e kantonit Rojshbyhl.
- Për pjesëmarrësit ndjekja e programit mbështetës është pa pagesë.

